



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 217, datë 26.05.2021

PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE FITUES NË
PROVIMIN E PRANIMIT NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR NË
SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS, PËR KËSHILLTAR DHE NDIHMËS LIGJORË,
VITI AKADEMIK 2021-2022
(azhornuar me vendimin nr.501, datë 25.10.2021)

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “d”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 90 pika 1, shkronja “dh” dhe 97, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 53 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në Kreun VI, Seksioni A, pikat 60-62 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, si dhe pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022, për profilin këshilltar dhe ndihmës ligjorë.
2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:
 1. Për z. Agim Korçari - relatore znj. Fatmira Luli;
 2. Për z. Alfred Gjonpali - relatore znj. Fatmira Luli;
 3. Për z. Leonard Kryeziu - relator z. Medi Bici;
 4. Për znj. Klaida Muçaj - relatore znj. Fatmira Luli;
 5. Për znj. Malvina Malaj - relator z. Medi Bici.
 6. Për znj. Romina Elezi - relator z. Medi Bici¹.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet secilit prej kandidatëve, të përfshirë në pikën 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

¹ Shtuar me vendimin nr.501, datë 25.10.2021